

KONTRATË SHITJEJE – PASURI TË PALUAJTSHME**Palët**

Shitësi: Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, një organ i pavarur i themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK 2002/12 datë 13 qershor 2002 - Mbi krijimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (sipas ndryshimeve tashmë në Rregulloren e UNMIK 2005/18) (këtu e më poshtë përmendet si “AKM”), që vepron si administratore në emër të Ndërmarrjes së identifikuar në Njoftimin për Shitje Publike të AKM që përmendet më poshtë.

Blerësi: Personi ose entiteti i identifikuar si Blerës më poshtë.

Sfondi shpjegues:

Blerësi është ofertuesi fitues në shitjen e kryer nga Shitësi për artikujt e identifikuar në Nenin 3 më poshtë me çmimin e specifikuar aty.

Termet dhe Kushtet:

Në këtë Kontratë fjalët dhe shprehjet kanë të njëjtin kuptim si edhe kuptimet e tyre të caktuara respektivisht në Dokumentet e Kontratës të përmendura më poshtë.

1. Dokumentet e mëposhtme (këtu e më poshtë të quajtura “Dokumentet e Kontratës”) konsiderohet se formojnë, dhe lexohen dhe interpretohen si pjesë përbërëse e Kontratës:
 - (a) Kjo Kontratë Shitjeje, ku përfshihen Kushtet e Punës Ligjore të Shitjes dhe Tabela A e këtij dokumenti, ku përfshihet çdo lloj Deklarate sipas Rregullores Nr. 2004/2 mbi Parandalimin e pastrimit të parave dhe veprat penale të lidhura me të me ndryshimet përkatëse nga Rregullorja Nr 2004/10 dhe Rregullorja Nr 2005/9;
 - (b) Njoftimi për shitje publike i bërë nga AKM për Numrin e Shitjes të identifikuar më poshtë;
 - (c) Rregullat e Tenderit për Shitje Pasurie të AKM me anë të një procesi ofertash konkurrues e të vulosur (“Rregullat e Tenderit”), ku përfshihen dokumentet e përmendura këtu.
2. Dokumentet e Kontratës plotësojnë njëra tjetrën. Megjithatë, në rast të ndonjë mospërputhjeje, dykuptimi ose kontradikte mes tyre, këto mbizotërojnë sipas renditjes së numërimit të përmendur më lart.
3. Kundrejt pagesës së çmimit të specifikuar më poshtë si konsideratë, Shitësi i shet Blerësit artikujt e identifikuar më poshtë.

Emri i ndërmarrjes	
Emrat	e

mëparshëm/alternativë të ndërmarrjes	
Numri i shitjes	
Numri i artikullit	
Përshkrimi i artikullit	
Çmimi (euro)	
Nënshkrimi: Për AKM	
Emri dhe titulli i personit që nënshkruan	
Nënshkrimi: Për Blerësin	
Emri i Blerësit	
Emri dhe titulli i personit që nënshkruan	

KUSHTET LIGJORE TE PUNËS SË SHITJES - PASURITË E LUAJTSHME

1. Pohime dhe mohime

- 1.1. Kuptohet që artikujt që i shiten Blerësit në bazë të kësaj Kontrate Shitjeje janë të përdorura, janë përdorur më parë nga një Ndërmarrje dhe/ose kanë qenë në zotërim të Ndërmarrjes. Për pasojë, Blerësi bie dakord që ti marrë artikujt në gjendjen e tyre të tanishme.
- 1.2. Blerësi pohon se i është dhënë mundësia të inspektojë artikujt dhe ndonjë dokumentacion të lidhur me to si dhe ndonjë regjistrim publik në Kosovë dhe bie dakord se ka kryer shqyrtimin e tyre siç e ka gjykuar të nevojshme për tu bindur për cilësinë dhe përshtatshmërinë e tyre për qëllimin për të cilin Blerësit i duhen dhe për të plotësuar standardet ose kërkesat e Ligjit të Zbatueshëm, ku përfshihen edhe kërkesat e regjistrimit. Blerësi në veçanti pohon dhe bie dakord me kushtet e Nenit 9 të Rregullave të Tenderit në këtë drejtim.
- 1.3. Për pasojë arrihet marrëveshje se, në masën që e lejon ligji, secili artikull shitet “siç është, ku është” dhe Shitësi dhe përfaqësuesi i tij mohojnë shprehimisht sa vijon:
 - 1.3.1. çdo detyrim dhe gjithë detyrimet për parashitesat, garancitë ose deklaratat që përmbahen në ndonjë material të shkruar (duke përfshirë pa kufizime Njoftimin për Shitje Publike dhe /ose broshurat e shitjes dhe përmbajtjet e çdo informacioni të dhomës së të dhënave) që i është dhënë Blerësit ose që gjendet në ndonjë informacion që i është transmetuar Blerësit gojarisht; dhe
 - 1.3.2. çdo parashitesë ose garanci të nënkuptuar në ndonjë ligj.
 - 1.3.3. Ky mohim nuk zbatohet për deklaratat e bëra me qëllim mashtrimi nga ana e Shitësit.
- 1.4 Blerësi pohon se do të mbajë përgjegjësi të vetme për çdo lloj regjistrimi ose eksporti ose leje të tjera të lidhura me artikujt ku përfshihet por që nuk kufizohet te kostot e këtyre regjistrimeve dhe Shitësi nuk garanton që këto regjistrime janë të mundshme për mallrat.

2. Humbja ekonomike

Në masën që lejohet nga ligji, bihet dakord që Shitësi nuk do të mbajë përgjegjësi në asnjë rrethanë në kontratë, delikt civil (ku përfshihet pakujdesia ose shkelje e detyrimet me statut) ose përndryshe në çdo mënyrë tjetër, dhe cilido qoftë shkaku i saj (i) lidhur me çdo lloj humbjeje fitimi, pune afariste, kontratash, të ardhurash, ose kursimesh të parashikuara, ose (ii) lidhur me ndonjë dëm të veçantë indirekt ose rrjedhimor të çdo natyre çfarëdoqoftë.

3. Pagesa, Titulli, Rreziku i Humbjes dhe Pranimi

- 3.1. Pagesa duhet të kryhet sipas parashikimeve në Rregullat e Tenderit, veçanërisht në Nenin 11 të tij, dhe në Dokumentacionin e Ofertës.
- 3.2. Titulli dhe rreziku i humbjes në lidhje me gjithë artikujt i kalon Blerësit në kohën e pagesës së plotë dhe nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitjeje nga të dyja palët, dhe Blerësi konsiderohet se pranon këta artikuj në këtë kohë.

4. Variacione në sasi ose peshë

- 4.1. Çdo variacion mes sasisë dhe/ose peshës së listuar nga Shitësi për çdo artikull dhe sasisë dhe/ose peshës së disponueshme për tu marrë në dorëzim nga Blerësi ose në

emër të Blerësit do të korrigojohet në bazë të çmimit për njësi të cituar për këtë artikull (nëse ka). Nëse nuk është cituar çmimi për njësi, atëherë do të bëhet korigjim ekuitabël nëse shuma e shpallur ndryshon nga shuma aktuale në masë më të lartë se 10%.

5. Dorëzimi dhe largimi i pasurisë

- 5.1. Dorëzimi konsiderohet se bëhet në vendndodhjen e artikullit të blerë në kohën e pagesës dhe ekzekutimit të kësaj Kontrate të Shitjes, kohë në të cilën artikujt e blerë duhet t'i kalojë Blerësit. Blerësi ka përgjegjësinë e vetme për çdo lloj transportimi, paketimi ose dogane apo masa të tjera.
- 5.2. Përveç kur parashikohet ndryshe në Njoftimin e Shitjes Publike ose kur jepet autorizimi me shkrim i Shitësit, Blerësi duhet të lëvizë gjithë blerjet jo më vonë se 10 ditë pas ekzekutimit të kësaj Kontrate Shitjeje. Në rastin kur Blerësi vonon, Shitësi ka të drejtën të kërkojë pagesë të arsyeshme magazinimi para se ta kalojë pasurinë në duart e Blerësit. Përveç kur bihet dakord ndryshe me shkrim, në rast se vonesa e Blerësit kalon tridhjetë ditët, Shitësi ka të drejtën të disponojë pasurinë pa pasur detyrime ndaj Blerësit dhe ka të drejtën të mbajë atë pjesë të çmimit të paguar nga Blerësi që përfaqëson diferencën mes (i) shumës së këtij çmimi plus koston e disponimit plus pagesat e papaguara të magazinimit të shpenzuara dhe (ii) çdo shume të marrë në kohën e disponimit.
- 5.3. Blerësi mban përgjegjësi për çdo dëm që shkaktohet nga Blerësi në lokalet ku ndodhet pasuria të shkaktuar nga veprimet e lëvizjes.
- 5.4. Përveç se kur parashikohet ndryshe në Njoftimin e Shitjes Publike, Blerësi, me shpenzimet e veta, duhet të marrë gjithë masat e nevojshme dhe të kryejë gjithë punët e nevojshme për të lëvizur pasurinë e blerë, ku përfshihet por që nuk kufizohet vetëm te paketimi, ngarkimi, transportimi, dhe gjithë zhdoganimet e nevojshme ose kërkesa të ngjashme. Shitësi nuk do të veprojë si ndërlidhës me asnjë transportues, dhe as nuk do të rekomandojë transportues.
- 5.5. Ndërsa Shitësi mund të përshkruajë se pasuria është e futur në kuti, e gatshme për tu lëvizur me paletë, e paketuar në kontejner, ose i paketuar në mënyra të tjera, Shitësi nuk jep garanci që këto lloj paketimesh janë të përshtatshme për lëvizje e transportim.
- 5.6. Nuk lejohen lëvizjet e pjesshme dhe as lëvizje që kryhen të shtunave, të dielave ose gjatë pushimeve të UNMIK përveç se kur bihet dakord me shkrim me Shitësin.

6. Ligji i Zbatueshëm

Kjo Kontratë Shitjeje qeveriset dhe interpretohet në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm të Kosovës.

7. Juridiksioni

Pohohet dhe bihet dakord se Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës ka juridiksion ekskluziv dhe përfundimtar mbi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

8. Pavlefshmëria e Shitjes

Pavarësisht nga neni 10.5 i Rregullores së UNMIK Nr. 2002/13 ose dispozitave të tjera në Ligjin e Zbatueshëm, nëse përcaktohet se (a) fondet e përdorura nga Blerësi për të blerë artikullin e blerë burojnë direkt ose indirekt nga veprimtari e paligjshme; ose (b) Blerësi ishte i përfshirë në marrëveshje të fshehtë gjatë procesit të ofertave ose në

ndonjë formë tjetër shkeljeje të Rregullave të Tenderit, atëherë kjo Kontratë Shitjeje konsiderohet e anulueshme nga Shitësi dhe Shitësi humbet çdo shumë depozite e ofertës .

9. Gjuha

Versioni në gjuhën angleze i kësaj Kontrate Shitjeje dhe Dokumenteve të tjera të Kontratës mbizotëron mbi çdo lloj përkthimi.

TABELA A

Deklaratë sipas Rregullores Nr 2004/2 Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe veprat e lidhura penale sipas ndryshimeve nga Rregullorja Nr 2004/10 dhe Rregullorja Nr 2005/9